

**LICENCË**  
**Nr.8, datë 25.11.1996**

**E BANKËS SË SHQIPËRISË DHËNË DEGËS SË BANKËS KOMBËTARE TË**  
**GREQISË**

Banka e Shqipërisë, në mbështetje të neneve 7 dhe 10 të ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë", të neneve 6 e 13 të ligjit nr.8076, datë 22.2.1996 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të vendimit nr.4, datë 14.3.1996 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i dha licencë Degës së Bankës Kombëtare të Greqisë në Tiranë, për të vepruar si Bankë në Republikën e Shqipërisë,

Licenca ka nr.08, datë 25.11.1996

Ajo e lejon Degën e Bankës Kombëtare të Greqisë në Tiranë të kryej veprimtaritë e mëposhtme:

1. Pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilën paguan ose jo interes.
  2. Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare.
  3. Kryerjen e shërbimeve të pagesave.
  4. Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera pagesat me kartë, me ceqet e udhëtarit dhe ceqet e bankierit).
  5. Ndërmjetësim për operacionet monetare (duke përfshirë valutat).
  6. Kryerjen e shërbimeve si agjentë financiar ose këshilltar financiar.
- Licensa është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.  
Veprimtaria fillon menjëherë.

**GOVERNATOR**  
**Kristaq Luniku**